



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 361/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha, dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së banerave mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Dardanë, me të cilën pretendohet se më 26.10.2013 në Rrethrotullimin afër tregut të qytetit në Dardanë, anëtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kanë vendosur banerë mbi rrugë publike të kandidatit për asamble komunale nga ky subjekt politik. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP, dhe nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013, në ora 16:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK sipas afatit të caktuar, ku konsideron se janë të pa baza pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me shkeljen e Rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b) të LZP dhe nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Po ashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se vendosja e posterit të Kandidatit të AAK-së për Asamble Komunale në Dardanë mbi rrugë publike nga fotografia e ofruara në ankesë nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se baneri i kandidatit të subjektit politik AAK, është i vendosur mbi rrugë publike , nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar dëshmi bindëse nga parashtruesi i ankesës të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 361/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*